



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:300245

Datë: 27.01.2021

Numri i dokumentit: 01449193

C.nr.08/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. S., Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Halili, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës K. e Gj.-D. K. e A., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B. M nga Gjilani, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjese, më datën 27.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar, kërkesëpadia e paditëses A. S. Komuna e Gjilanit, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – D. K. e A., që t’ia kompensojë paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga dt.18.04.2017 e deri më dt.11.03.2020, shumën prej 1078.00 euro (për 539 ditë), në emër të kompensimit për shpërblimin jubilar t’ia kompensoj shumën prej 210.50 euro, në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 155.40 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,443.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, që paditëses A. S nga Komuna e Gjilanit, të i’u paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumë prej 271 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m

Duke pasë parasysh faktin se kërkesëpadia e paditëses ka të bëjë me kompensimim e shpenzimeve për ushqim, shpërblim jubilar dhe shpenzime të udhëtimit, e që kontestet e tilla sipas përmbajtjes së padisë, por edhe sipas praktikës gjyqësore nuk rezultojnë të jenë të komplikuar, gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës (padinë, përgjigjen në padi dhe provat e bashkëngjitura padisë), me qëllim që gjykimi të jetë sa më efikas dhe ekonomikisht i arsyeshëm, e në përpjekje që procedura gjyqësore të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, dhe duke u bazuar në nenin 401 e lidhur me nenin 10 paragraf.1 të LPK-së, ka vendosur që mos të konvokoj seancën përgatitore, por që drejtpërdrejt ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësja A. S, Komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit së saj, Enver Halili, avokat nga Gjilani, në këtë gjykatë me dt.30.12.2019 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, padi kjo e ndryshuar dhe precizuar në kuptim objektiv nga i autorizuari i paditëses me parashtrësën e dt.09.10.2020, edhe atë para se të caktohej shqyrtimi gjyqësor, lidhur me çështjen juridike kontestimore për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, shpërblim jubilar dhe shpenzime të udhëtimit. Në padi ka theksuar se paditësja që nga viti 2004 ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse e lëndës së biologjisë në SHFMU “S” ...në , Komuna e Gjilanit, ku edhe tani punon, dhe në bazë të Kontratës së Punës se lidhur mes paditëses dhe të paditurës, ka normë pune prej 20 orë në javë, realizon të ardhura mujore të një page neto prej 455.10 euro, ndërsa bruto prej 509 euro, dhe e njëjta ka mbi 10 vite përvojë pune. Nga këto arsye dhe nga kjo bazë, e njëjta ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj ushqimin për ditet e pranisë në punë për periudhën nga dt. 18.04.2017 deri më dt. 06.02.2020 për 516 dite punë shumën prej 1032 euro, t’i kompensoj shumën prej 210,50 euro, shume kjo e kërkuar në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e punës mbi 16 vite, t’i kompensoj shpenzimet e udhëtimit në lartësi të 70 % të biletës së udhëtimit për dy drejtime për 222 ditë pune, në shumën prej 155,40 euro, e llogaritur sipas biletës së paguar nga paditësja në shumë prej 1 euro për dy drejtimet, e me decidivisht sikurse në padinë e precizuar sipas parashtrësës së dt.09.10.2020.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës (në vijim: KPKK) të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe S. e B. e A., Skencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 6 dhe 7 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti i dt.06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Si arsye tjetër ka cekur se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Më tej ka shtuar se pagat jubilarë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve, dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkalim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë, ngase paditësi nuk e ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë në afat prej 30 ditësh, ndërsa sipas LMD-së, neni 353 par.3 dhe neni 357 par.1 dhe neni 87 të Ligjit të Punës, ka theksuar se kemi parashkrim të lëndës, për arsye se tashmë paditësja ka 15 vite përvojë të punës ndërsa dihet se një e drejtë e tillë i ka takuar pasi që paditësja i ka bërë 10 vite përvojë të punës, që do të thotë se një kërkesë të tillë e ka bërë pas 5 viteve. Përveç tjerave, e paditura ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur, dhe në fund ka shtuar se nuk janë

shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditëses, andaj nga këto arsye ka propozuar që padia dhe kërkesëpafia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

I autorizuari i paditëses, në fillim të seancës për shqyrtimin kryesor e ka precizuar kërkesëpadinë e paditëses vetëm sa i përket kompensimit të kërkuar për ushqim, ashtu që pas precizimit të kërkesës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses për ditët e pranisë në punë nga dt. 18.04.2017 e deri me dt.11.03.2020, përkatësisht për 539 ditë pune, nga 2 (dy) euro për një ditë pune, t'ia kompensoj paditëses shumë prej 1078 euro. Edhe gjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar, si precizimit të së njëjtës, dhe i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë të bazuar në ligj kërkesëpadinë e paditëses. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore, edhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për taksë gjyqësore shumë prej 32 euro, për parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë shumë prej 67.50 euro, si dhe për përfaqësim në një seancë shumë prej 135 euro.

I autorizuari i të paditurës në seancën për shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe thënieve të deklaruara në këtë seancë, dhe e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke konsideruar se kërkesa e paditëses sa i përket shpërblimit jubilar në bazë të nenit 353 par.3 dhe nenit 357 par.1 të LMD-së të vitit 2012, si dhe nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar, pasi që paditësja i ka mbushur 15 vite përvojë pune dhe se se një e drejtë e tillë i ka takuar pasi që paditësja i ka bërë 10 vite të përvojës së punës, pra një kërkesë të tillë e ka bërë pas 5 viteve. Nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar, dhe në fund ka kontestuar edhe shpenzimet e procedurës të kërkuara nga i autorizuari i paditëses. Përveç tjerash, vlen të ceket se i autorizuari i të paditurës gjatë kësaj seance ka deklaruar se për të paditurën nuk është kontestues fakti për ditët e pranisë në punë të paditëses, e po ashtu nuk është kontestues as lartësia e kërkesëpadisë, dhe nuk i ka kundërshtuar provat e propozuara për administrim nga pala paditëse, për më tepër nuk ka pas vërejtje në administrimin e tyre.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor :

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Kontraten e punës, me nr...., te dt. 01.09.2015; Kërkesën për kompensimin e punëtorëve drejtuar DKA-së – Komunës së Gjilanit, te dt. 23.12.2019; Pagesen për nënpunësen A. S, me nr. ... prej dt.01.11.2019 e deri me dt.30.11.2019; Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “...” në për Ajshe Salihu, me nr. ..., te dt.07.02.2020; Njoftimin e lëshuar nga SHFMU “S.” për kuzhinën e shkollës, me nr. ..., te dt.07.02.2020; Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “S.”... për A. S, me nr. , të dt.11.03.2020; Vërtetimin e lëshuar nga NT “E.” për A. S, të dt.11.03.2020; Certifikatën e Vendbanimit për A. S, me nr. serik..., të dt.19.06.2020; Vërtetimin me nr. ..., nga dt.18.04.2017 e deri më dt. 11.03.2020; Vërtetimin nga e njëjta shkolle, me nr.... nga dt.11.03.2020; Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “S.” ne , me nr...., te dt. 06.02.2020; Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “A... T”,... me nr. ..., te dt.05.06.2008; Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “M.Z.”... ne Gjilan, me nr. ... te dt. 25.11.2011 dhe Dëshminë-çmimoren e udhëtimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit Rrugor të Udhëtareve “Anamorava” ne Gjilan, me nr...., të dt.05.03.2020.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi:

Gjykata gjeti se për palët ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune të e paditura nga periudha kontestuese, pastaj nuk ishte kontestues fakti për të paditurën edhe ditët e pranisë në punë të paditëses për periudhën e kërkuar, e po ashtu, për të paditurën nuk ishte kontestues as lartësia e kërkesëpadisë, mirëpo, si kontestues për palën e paditur ishte baza juridike e padisë, pasi që e paditura konsideron se nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, edhe atë nga arsyet e cekura sikurse në përgjigje në padi. Po ashtu, nga e paditura në këtë çështje është ngritur edhe çështja e parashkrimit të kërkesës së paditëses sa i përket kërkesës për shpërblimin jubilar.

Nga Kontrata e Punës me nr...., të dt.01.09.2015, gjykata ka vëretuar faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me datën 01.09.2015, me kohë të pacaktuar, me pozitë të punës si mësimdhënëse e lëndës së Biologjisë, në SHFMU “S.” në .

Nga Kërkesa me shkrim e paditëses drejtuar të paditurës, e dt. 23.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja paraprakisht ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shpenzimeve për ushqim, të shpërblimit jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të transportit, por e paditura ka heshtur në lidhje me këtë kërkesë.

Nga Lista e pagave për nënpunësen, në këtë rast paditësen, me nr. ... prej dt. 01.11.2019 e deri me dt. 30.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja realizon pagë mujore neto në shumë prej 455.10 euro, ndërsa paga bazë e së njëjtës është shuma prej 421 euro.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu” në , me nr.249, i dt. 07.02.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja gjatë viteve shkollore ..., ..., ... dhe ..., respektivisht prej dt. 18.04.2017 e deri më dt. 06.02.2020, ka të kaluara 516 ditë punë, në vendin e saj të punës.

Nga Njoftimi i lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu” në P., me nr. ..., i dt. 07.02.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo shkollë së bashku me dy paralelet e saja të ndara nuk ka kuzhinë për përgatitjen e ushqimit dhe se asnjë punëtor i tyre nuk shërbehet në shkollë në ushqim dhe as nuk ka kushte për përgatitje.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu” në .ë, me nr. ..., i dt.11.03.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja gjatë viteve ..., ..., ... dhe ..., respektivisht nga dt. 18.04.2017 e deri me dt. 11.03.2020 ka 222 ditë të udhëtimit.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga NT “Egnatia”, i dt. 11.03.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja është udhëtare e rregullt në kompaninë e transportit të udhëtarëve “NT Egnatia”, dhe që nga viti 2016 paguan biletën për dy drejtime në shumë prej 1 euro (d.m.th nga 50 cent për një drejtim).

Nga Certifikata e Vendbanimit, me nr. serik ..., e dt.19.06.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka vendbanimin në fshatin .

Nga Vërtetimi me nr... nga dt. 18.04.2017 e deri me dt.11.03.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja në SHFMU“S.”, ka filluar punën në shkollën në fjalë nga data 01.09.2010 dhe ende vazhdon të punojë në këtë shkollë, dhe gjatë viteve shkollore ..., ..., ... dhe ..., ka gjithsej 539 ditë pune.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga po e njëjta shkollë, me nr... nga dt.11.03.2020 i cili ka të bëjë me ditët e udhëtimit në Shkollën Fillore në fsh.Kmetoc dhe anasjelltas, gjykata ka vërtetuar faktin se për vitet shkollore ..., ..., ... dhe ..., ka 222 ditë të udhëtimit.

Nga Dëshmia-çmimorja e udhëtimit e lëshuar nga Sh. e T. Rr.te Udhëtarëve “Anamorava”... ne Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se në linjën për të cilën udhëton, vetëm për një drejtim çmimi i biletës figuron të jetë 0.50 euro.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Musa Zajmi” ne Gjilan, me nr..., i dt.25.11.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka qenë punëtore në këtë shkollë si arsimtare e Biologjisë për 2 vite, vërtetim ky i lëshuar nga Drejtoria e shkollës së lartëcekur.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Abdullah Tahiri”, me nr. ... i dt.05.06.2008, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka qenë punëtore në pozitën e arsimtares së biologjisë nga dt. 12.03.2003 deri me dt. 03.06.2003, dhe nga dt.20.09.2004 deri me dt. 31.08.2006, respektivisht ka përvojën e përgjithshme nga puna në këtë shkollë prej 2 vite, 2 muaj e 2 ditë.

Baza juridike:

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: *1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4 parag.2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”. Sipas nenit 35 parag.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, ndërsa sipas parag. 5 të po këtij neni*

është përcaktuar se: *“Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së caktuar, i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban”, sipas nenit 35, paragrafi 8, pikat 1 dhe 5 të kësaj Kontrate është përcaktuar qartë se: “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej : për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50 % të një page baze”, pika 8.5 “ Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar i ka plotësuar kushtet e shpërbilimit sipas kriterëve përkatëse”.*

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe të njëjten e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, pasi që gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune të paditura, dhe e njëjta punon si mësimdhënëse në SHFMU “...” dhe në paralelën e ndarë në Kmetoc, me kontrate në kohë të pacaktuar, dhe realizon të ardhura mujore në shumën e cekur më lartë, ka përvojë pune mbi 10 vite, dhe si ditë të pranisë në punë ka 539 ditë, ndërsa ditë të udhëtimit për shkuarje dhe kthyerje në shkollat e cekura nga vendbanimi i saj në Përlepnice ka gjithsej 222 ditë, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë, përkatësisht nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, gjeti se paditëses i takon e drejta që për ditët e pranishme në punë t’i kompensohet shuma prej nga 2 euro në ditë për ushqim gjatë ditëve në punë, edhe atë nga data 18.04.2017 e deri më dt. 11.03.2020, përkatësisht për 539 ditë të pranisë në punë, e që i bie që paditëses për 539 ditë të pranisë në punë, llogaritur nga 2 euro për një ditë pune (kalkuluar: $539 \times 2 = 1078$) i takon shuma prej 1078 euro, pasi që me provat e cekura më lartë është vërtetuar se paditësja për vitet shkollorë 2016/17, 2017/18, 2018/19 dhe 2019/20 ka gjithsej 539 ditë pune. Për më tepër, ky fakt nuk ka qenë kontestues nga e paditura, sepse gjatë seancës për shqyrtimin kryesor ka deklaruar se nuk i konteston ditët e pranisë në punë të paditëses si dhe lartësinë e kërkesës. Po ashtu, gjykata bazuar në nenin 35 paragrafi 8 pikat 8.1 dhe pika 8.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, gjeti se paditëses i takon e drejta e kompensimit për shpërblimin jubilar e një page baze prej 50 % për shkak të përvojës së punës të e paditura me mbi 10 vite të përvojës së punës, ashtu që të njëjtes i takon 50 % e një page baze, pasi që në bazë të provave të administruara, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka pagën bazë 421 euro, e duke llogaritur shumën prej 421 euro me 50 % të një page baze ($421 \times 50 \% = 210.5$), rezulton se paditëses i takon e drejta për shpërblim jubilar për lartësinë e aprovuar në shumë prej 210.50 euro, ndërsa sa i përket shpenzimeve të udhëtimit të paditëses nga vendbanimi i saj në SHFMU “Skënderbeu”, përkatësisht në paralelën e ndarë në Kmetoc, gjykata duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, gjeti se paditëses i takon e drejta për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi të 70% të një bilete të trafikut urban, shumë kjo e llogaritur për 222 ditë pune sipas biletës së paguar nga paditësja për çdo ditë udhëtimi nga 1 euro ($222 \times 70 \% = 155.40$), e që i bie që paditëses për 222 ditë udhëtimi për biletën e paguar prej 1 euro për çdo ditë, i takon e drejta në kompensim në shumë prej 155.40 euro. Për më tepër, edhe sa i përket kësaj kërkesë nga e paditura nuk është kontestuar lartësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës se paditëses, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që paditësja në shtator të vitit 2014 i ka mbushur 10 vite përvojë pune, e që në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar, prandaj paditësja nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë, kurse padinë me kërkesat e saj në gjykatë i ka paraqitur me datën 30.12.2019, çka do të thotë se në afatin e paraparë ligjor sipas dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e për më tepër Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, dhe në bazë të kësaj paditësja nuk ka mundur ta ushtroj këtë kërkesë, pasi që para kësaj date nuk ka qenë në fuqi kjo kontratë dhe e njëjta prodhon efekt nga momenti i nënshkrimit të saj. Nga kjo rrjedh se paditëses, e drejta e saj subjektive për të kërkuar përmbushjen e detyrimeve sipas Kontratës Kolektive të Arsimit i derivon pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, e jo para datës së kësaj kontrate. Nga këto arsye rezulton se padia e paditëses është parashtruar brenda afatit ligjor, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës ku ka cekur se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mesimdhënësve dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. Pos tjerash, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe nga fakti se Kontrata Kolektive e Arsimit është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të Ligjit të Punës (nenin 90 i këtij Ligji), e po ashtu edhe me dispozitën e nenit 2 të kësaj kontrate është paraparë se dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar ku bënë pjesë edhe paditësja. Pastaj është caktuar qartë se dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA-të, ku në këtë rast është e paditura. Nga këto arsye gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga Kontrata Kolektive e Arsimit, pasi që kjo kontratë është lidhur në nivel vendi dhe në pajtueshmeri me dispozitat e Ligjit të Punës.

Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është regjistruar fare në faqen Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në vijim: MPMS), dhe si e tillë nuk duhet të prodhoj efekt juridik, po ashtu, gjykata një pretendim të tillë nuk e mori për bazë, sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevante se a është regjistruar apo jo Kontrata në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të kësaj Kontrate është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme, dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i Kontratës). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njëjtën ta regjistroj apo depozitoj, e për të cilat

lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësoj paditësi.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata për shpenzimet e procedurës kontestimre ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452, paragrafi 1, të LPK-së, pasi që paditësja ka pasur sukses në procedurë, por edhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës në mënyrë të specifikuar, edhe atë: në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104 euro; në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë, shumën prej 32 euro; dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumën prej 135 euro, ndërsa gjykata refuzoj pjesën tjetër për paraqitjen e parashtresës në shumë prej 67.50, bazuar në nenin 453 parag.1 të nenit të lartëcekur, pasi që i njëjti ka mundur që ta precizojë padinë e tij në seancën për shqyrtimin kryesor, dhe gjykata nuk e pa si shpenzim të nevojshëm për ndjekjen e çështjes në gjyq.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 08/20, i datës 27.01.2021

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.